



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 622/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.09.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e BOE “Biba-X” sh.p.k & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-22807-05-20-2019, me objekt: “*Rikonstruksion rruga Taulantia (segmenti Hotel Arvi – Hotel Aragosta)*”, me fond limit 20.833.000 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 20.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Caushi M” sh.p.k.

Ankimues: BOE “Biba-X” sh.p.k & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k
Fshati “Kryeluzaj”, 50 km pranë karburantit “Eurodrin”, Kavajë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës
Sheshi “Liria”, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-22807-05-20-2019, me objekt: “*Rikonstruktion rruga Taulantia (segmenti Hotel Arvi – Hotel Aragosta)*”, me fond limit 20.833.000 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 20.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 16.07.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Caushi M” sh.p.k	12.072.290 lekë, kualifikuar
2. “Biba-X-X” sh.p.k	13.158291 lekë, skualifikuar
3. “K-AAV” sh.p.k.	14.152.123 lekë, skualifikuar
4. “Varaku E” sh.p.k	16.962.658 lekë, kualifikuar
5. “Sireta 2F” sh.p.k	17.777.777 lekë, kualifikuar
6. “Shendelli” sh.p.k	18.541.185 lekë, skualifikuar
7. “Leon Konstruktion” sh.p.k	19.371.280 lekë, skualifikuar

BOE "Biba-X" sh.p.k & "Pe-Vla-Ku" sh.p.k rezulton i skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me argumentat si më poshtë vijon:

Për bashkimin e operatoreve ekonomike BIBA-X- X + PE-VLA-KU me vlere te ofertes 13'158'291 lekë, KVO konstatoi:

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 "Për kapacitetin teknik", ne germen k jane kerkuar;

List pagesat sipas formularëve standard për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj të vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 39 persona me kohë të plotë pune, këtu përfshihet: "Stafi teknik i shoqërisë" sipas pikës "h" dhe "Licencat profesionale të shoqërisë" sipas pikës "g".....

- Persa i perket pikes ku perفشihen punonjesit ne: "Licencat profesionale të shoqërisë" sipas pikës "g", per operatorin PE-VLA-KU rezulton se, ne Licencen e tij profesionale NZ.5147/13, Regjistruar ne Regjistrin themeltar qe nga data: 14.01.2019, drejtuesi teknik: Gezim Bisha nuk eshte i perfshire ne liste pagesa për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit me kohë të plotë pune, por me 6 dite pune, drejtuesja teknike Adelina Dukaj nuk eshte e perfshire ne liste pagesa për sigurimet, për tre muajt e fundit me kohë të plotë pune, por me 11 dite pune, ndersa drejtuesja teknike Alma Velaj nuk eshte e perfshire ne liste pagesa, muajin e fundit para hapjes se ofertave(Maj të vitit 2019).

KVO vendos qe bashkimi i operatoreve ekonomike BIBA-X- X + PE-VLA-KU te mos kualifikohet.:

II.3. Në datën 23.07.2019, BOE "Biba-X" sh.p.k & "Pe-Vla-Ku" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton s'kualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë "Caushi M" sh.p.k. Konkretisht pretendohet si vijon:

"Ne baze te nenit 63, pika 2 e Ligjit Prokurimit Publik Nr.9643, date 20.11.2006, ndryshuar, qe parashikon se cdo person qe ka ose ka pasur interes ne nje procedure prokurimi dhe kur eshte i demtuar ose rrezikohet te demtohet nga nje vendim i Autoritetit Kontraktor mund te paraqese ankese me shkrim prane Autoritetit brenda 7 diteve nga dita e neserme e punes kur ankimuesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per shkeljen e pretenduar sipas ketij ligji. Brenda afateve ligjore 7 dite nga dita e neserme e punes paraqesim ankesen tone ndaj skualifikimit te padrejte te operatoreve Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "BIBA-X X" Sh.p.k. & "PE-VLA-KU" Sh.p.k me perfaqesues shoqerine "BIBA-X X" Sh.p.k., dhe ne kundërshtim me kerkesat te percaktuara ne Dokumentat Standarde te Tenderit per proceduren prokuruese me objekt "Rikonstruksion rruga Taulantia (segmenti Hotel Arvi -Hotel Aragosta)", kualifikimin e padrejte te operatorit ekonomik "Caushi M", klasifikimin e ofertes se ketij operatori si Anomalisht e Ulet. Paraqesim pretendim tona si me poshte shenuar:

Se pari: Shoqeria "BIBA-X X" Sh.p.k., ne cilesine e perfaqesuesit te Bashkimit te Operatoreve Ekonomik "BIBA-X X" Sh.p.k. & "PE-VLA-KU" Sh.p.k, ka plotesuar dhe permbushur kerkesen kapacitetin teknik ne piken g, kur perkatesisht kerkohet sipas Kriereve/Kerkesave te Pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit per proceduren prokuruese me objekt "Rikonstruksion rruga Taulantia (segmenti Hotel Arvi-Hotel Aragosta) ".

g.Licenca profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates:

NP-1 A - Punime germimi ne toke.

NP-4 A- Ruge. autostrada. mbikalime. hekurudhe. tramvai. metro. pista aeroportuale.

NP-12 A-Punime te Inxhinierise se Mjedisit

NS-6 A- Sinjalistika rrugore jo ndricuese

NS-18 A- Punime topogjeodezike

Bashkimi i operatoreve ekonomik ka dorezuar Licencat profesionale perkatesisht:

Shoqeria "BIBA-X-X" Sh.p.k Licencen me nr 4319/6, me nr 1016, date 05.03.2019, duke plotesuar te gjitha kategorite e kerkuara ne piken G. Gjithashtu Operatori Ekonomik "Pe-Vla-Ku" sh.p.k ka paraqitur Licencen Profesionale me NZ5147/13 ku ploteson te gjitha kategorite per punimet e ekzekutimit te kontrates te kerkuara ne piken g.

Se dyti: Perkatesisht ne piken "h" kerkohet sipas Kritereve/Kerkesave te Pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit per proceduren prokuruese me objekt "Rikonstruksion rruga Taulantia (segmenti Hotel Arvi -Hotel Aragosta)"

"h.Stafi teknik i shoqerise te kete ne perberje:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Hidrodroteknik 1 (një)
- Ing.Topograf 1 (një)
- Ing.Mjedisi 1 (një)
- Mjek 1 (një)
- Teknik Ndëtimi 1 (një)
- Drejtues mjeti 7 (shtatë)
- Manovratore 5 (pesë)
- Punetori e specializuar ne ndertim:

asfalotshtues	2 punonjës
karpentiere	2 punonjës
hekurkthyes	2 punonjës
Punetore ndertimi te thjeshte	15 punonjës

Per stafin e sipercituar te paraqitet dokumentacion qe verteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve, licencen e mjekut, deshmi profesionale te punonjesve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj, ndersa per punetore te thjeshte ndertimi, te paraqitet nje vetedeklarim te listes nga shoqeria, ku te deklaroje se jane punetore te thjeshte ndertimi."

Per permbushjen e pikes h., Bashkimi i operatoreve Ekonomike "BIBA-X-Xsh.p.k & "PE-VLA-KU"sh.p.k kane paraqitur h.Stafi teknik i shoqerise te kete ne perberie:

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje) Ing.Lorenc Bani
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)Ing. Klodian Zaimi
- Ing. Topograf 1 (nje)Ing.Bajram Muji
- Ing. Mjedisi 1 (nje)Ing.Arbana Kola

Dhe te gjithe pjesen tjeter te stafit te kerkuar ne piken h, duke e permbushur teresisht dhe ne perputhje me kerkesen ne DST.

Se treti : Ne lidhje me permbushien e pikes k sipas DST ku kerkohet :

k.List pagesat sipas formuleve standard per sigurimet, per gjashte muajt e fundit (Dhjetor te vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars. Prill. Maj te vitit 2019, ndersa subjektet e biznesit te vogel

sipas legjislacionit ne fuqi), ku numri i punonjesve te jete minimumi 39 persona me kohe te plote pune, ketu perfshihet: "Stafi teknik i shoqerise" sipas pikes "h" dhe "Licencat profesionale te shoqerise" sipas pikes "g" (sqarojme se: per "Mjekun ", do te zbatohet legjislacioni ne fuqi). Dokumenta te konfirmuara nga institucioni perkates sipas legjislacionit ne fuqi (nepermjet formes elektronike).

Bashkimi i operatoreve ekonomike Shoqeria "BIBA-X-X"sh.p.k & Shoqeria "BIBA-X-X" Sh.p.k, bazuar ne Neni 46 Pika b) ku thuhet se: Kualifikimi i ofertave behet ne baze aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates etj.

Duke u bazuar ne keto pika Shoqeria "BIBA-X-X"sh.p.k & Shoqeria "BIBA-X-X"Sh.p.k kane plotesuar

Aftesite Teknike te pikave g.h.k te DST, duke paraqitur Licencat e kerkuara me kategorite dhe me Stafin teknik te kerkuar ne piken h te DST, me kohe te plote pune dhe prezent ne listpagesa per periudhen e kerkuar Dhjetor 2018-Maj 2019 Ing L.Bani, Ing K.Zaimi, Ing B.Muji, Ing. A.Kola.

Se katerti: Ne vazhdimesi te arsyes se skualifikimit ne menyre te padrejte Autoriteti Kontraktor argumenton si me poshte :

Per sa i perket pikes ku Regjistruar ne Regjistrin Themeltar qe nga data 14. 01.2019 drejtuesi Teknik Gezim Bisha nuk eshte i perfshire ne listpagesa per sigurimet, per gjashte muajt e fundit me kohe te plote pune, por me 6 dite pune, drejtuesia teknike Adelina Dukaj nuk eshte e perfshire ne listpagesa per sigurimet per 3 muajt e fundit me kohe te plote pune, por me 11 dite pune, ndersa drejtuesja teknike Alma Velaj nuk eshte perfshire ne listpagesa muajin e fundit para hapjes se ofertave (Maj viti 2019). KVO vendos qe bashkimi i operatoreve ekonomik BIBA-X-X & Pe-vla-ku shpk te mos kualifikohet.

Bazuar ne Ligjin "Per Prokurimin Publik" Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr.10170, date 22.10.2009, Ligjin Nr. 10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, dhe Ligjin Nr. 182/2014 dhe Vendimit Nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", neni 55 pika 2 thote: Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per te percaktuar oferten fituese, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nuk duhet te perdoret asnie kriter, qe nuk eshte perfshire ne dokumentat e tenderit. Pra Autoriteti Juaj Kontrator del pertej asaj c'ka kerkon ne DST e tenderit, duke analizuar te gjithë Drejtuesit Teknik te Licences te shoqerise "Pe-vla-ku", te leshuar me 14.01.2019, Drejtues Teknik te panevojshem per realizimin e kontrates, sic jane Gezim Bisha Ing .Gjeodet, Adelina Dukaj dhe Alma Velaj per aq kohe sa Kriteret e kerkuara jane permbushur nga bashkimi i operatoreve ne propocion me perqinden e pjesemarrjes se tyre ne bashkim.

Edhe sikur keta Inxhinier te ishin te nevojshem per realizimin e kontrates me objekt si me lart, Autoriteti Juaj Kontraktor del pertej Kompetenca qe i takon duke Analizuar nje Licence te Leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjiise qe mban daten 14.01.2019, ku per marrjen e kesaj Licence jane dorezuar te gjitha Kontratat Individuale te Punes qe mbajne te viteve 2017.

Bazuar ne Vendimin nr. 42. date 16.1. 2008 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullores per kriteret, procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve iuridike qe ushtroine veprimtari ndertimi", te ndryshuar. KREU IV DREJTUESI TEKNIK I SHOQERISE DHE PAPAJTUESHMERIA ME KETE DETYRE, ku ne piken b) dhe c) thuhet qartazi se:

b) Licenca profesionale e shoqerise kategorizohet mbeshtetur ne diplomimin dhe pervojen personale te drejtuesit/drejtuesve teknike, kerkesave te tjera qe caktohen ne kete rregullore dhe vleresimit te komisionit per dokumentacionin e paraqitur.

c) Marredheniet e drejtuesit teknik me shoqerine rregullohen sipas kontrates individuale te punes. Pra marredheniet e Drejtuesit Teknik me Subjektin rregullohen sipas kontrates individuale te punes.

Bazuar në Kodin e Punës me nr. Ligi 7961, datë 12.07.1995 dhe i ndryshuar me nr. 8085, datë 13.03.1996, ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe i ndryshuar, ku në nenin 14, pika 1 dhe 2 thuhet se: "Me kontraten e punes me kohe te pjeseshme punemarresi pranon te punojë me ore, gjysem dite pune ose dite pune per nje kohezgjatje normale javore ose mujore me te vogel se ajo e punemarresve qe punojne me kohe te plote ne te njejtat kushte."

Pika 2 neni 14 thuhet: "Punemarresi me kohe te pjeseshme gezon te njejtat te drejta perpjesetimisht si pune marresi me kohe te plote pune."

Si mundet Autoriteti Juaj Kontraktor te skualifikoje nje Operator Ekonomik qe, ne perputhje me ligjin, paraqet dokumentacionin ne kete procedure?

Se pesti: Operatori Ekonomik Caushi M, eshte kualifikuar ne menyre te padrejte, pasi oferta e tij eshte anomalisht e ulet. Oferta e paraqitur nga ky operator ne vleren prej 12 072 290 (dymbedhjete milion e shtatedhjete e dy mije e dyqind e nentedhjete leke) ka nje ulje prej 42 % nga vlera e fondit limit qe eshte 20 833 000 (njezet milion e teteqinde e tridhjete e tre mije) Leke.

Eshte detyre e Autoritetit Kontraktor qe ne perputhje me Ligjin "Per Prokurimin Publik" Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr.10170, date 22.10.2009, Ligjin Nr. 10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, dhe Ligjin Nr. 182/2014 dhe Vendimit Nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", neni 66 dhe ne perputhje me nenin 56 te LPP duhet ti kerkonte Operatorit Ekonomik te paraqiste argumentat sic e parashikon LPP per :

a) Anen ekonomike te metodes se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara

b) Zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve.

c) Origjinalitetin e puneve, mallarave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi.

d) Zbatueshmerin e detyrimve, e lidhen me mbrojtjen ne pune dhe ne kushtet e punes ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet fumizimi.

Per sa me siper Operatori Ekonomik Caush M duhet ti vertetojë Autoritetit Kontraktor dhe KVO, duke filluar qe nga realizimi i zerave si me poshte, bazuar ne VKM 629 dt 15.07.2015.

<i>Nr</i>	<i>Nr.An</i>	<i>Zërat e Punimeve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi</i>	<i>Totali</i>
1	Analiza 3	Shtrese binderi me zall lavatrice 6cm, me makineri ne zonat e demtuara	m2	800	1.576,00	1.260.800
2	Analiza 4	Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice 4 cm, me mak	m2	8380	1.293,00	10.835.340
3	2.262/4	Struktura monolite betoni C 16/20 (per kuneta) ne zonat e demtuara	m2	24	8.525,00	204.600
4	An-6	Shtirim me beton te ngjyrosur (te percaktohet nga investitori), me perberes inerte te perzgjedhur me grimca te vogla (0-5 mm), trashesi min.6 cm, finiture lisho anti-rreshqitje (chromofibre)ne trotuare (marka e betonit M-500)	m2	1696	640,00	1.085.440
5	2.262/4	(20X20) trashesia e betonit 10 cm (cmimi pa perfshire zgaren e hekurit) ne trotuare.	m2	167	8.525,00	1.423.675
					<i>Vlera Totale</i>	14.809.855

Vetem punimet asfaltike dhe ato te fumizimeve me beton zene 71 % te vleres se preventivit te punimeve. Si mundet qe ky Operator Ekonomik te ofroj nje realizim punimesh me nje ulje prej 42 % e vleres se kontrates kur praktikisht ndodhet me Seli qendrore me adrese sipas QKB me Fier Ballsh Mallakaster, Bulevard Rrapo Hekali shkalla 1, kati I-re, Zona Kadastrale 1090 nr pasuerie 7/9810/Ndertese, si do realizoje ky Operator Ekonomik Furnizimin me materiale Asfaltobeton dhe Betoni.

•Kur vetem Distanca e objektit te Prokurimit nga adresa e Operatorit Caushi M eshte 114 km (vend depozitimi i inerteve, materialeve te ndryshme, vendodhja e makinerive dhe pajisjeve). Qe do te thote se kostot e transportit qe nevojiten per sjelljen e makinerive dhe transportin e materialeve qe duhen per zbatimin e punimeve ne kete objekt, nuk jane aspak ne perputhje me bazuar ne VKM 629 dt 15.07.2015 dhe ne rastin se ky furnizim do te kryhej nga furnitore te zones eshte detyre e KVO qe ta kerkonte kete dokument ne momentin qe njihet me kete oferte.

•Gjithashtu KVO duhet te verifikoj nese makinerite e deklaruar ne shtojcen Nr 10 jane ne pronesi te tyre te gjitha makinerite dhe pajisjet e nevojshme per punimet e mesiperme te zbatimit te deklaruar. Ndodhur ne rrethana dhe fakte te tilla ka kosto qeraje mjete gjate zbatimit te punimeve. Pra nje arsye me teper per ta shpallur oferten e Caushi M Anomalisht te Ulet.

Persa me siper parashtruar, subjekti BIBA-X X ka plotesuar kriterin ne DST Shtojca 12 pika 2.3 "Per kapacitetin Teknik ", ne germen K jane kerkuar: List pagesat sipas formuleve standard

per sigurimet, per gjashte muajt e fundit (Dhjetor te vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019, ndersa subjektet e biznesit te vogel sipas legjislacionit ne fuqi), ku numri i punonjesve te jete minimumi 39 persona me kohe te plote pune, ketu perfshihet: "Stafi teknik i shoqerise" sipas pikes "h" dhe "Licencat profesionale te shoqerise" sipas pikes "g" te kerkesave te pergjithshme te kualifikimit percaktuar ne Dokumentat Standarte te Tenderit.Vendimi i refuzimit te subjektit tone eshte diskriminuar dhe jo i barabarte me subjektet e tjera.

II.4. NËPËRMJET SHKRESËS NR. 6921/2 PROT., DATË 24.07.2019 AUTORITETI KONTRAKTOR I KA KTHYER PËRGJIGJE ANKIMUESIT DUKE E REFUZUAR ANKESËN SI VIJON:

"Sqarojme se operatoret ekonomik ne bashkim Biba-X X shpk dhe PE-VLA-KU shpk nuk i kane permbushur kriteret e kerkuara ne DT, publikuar ne faqen zyrtare te APP dhe konkretisht per:

2.3 "Per kapacitetin teknik", germa "k" ku eshte kerkuar:

k. Listepagesat sipas formuleve standard per sigurimet, per gjashte muajt e fundit (Dhjetor te vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019, ndersa subjektet e biznesit te vogel sipas legjislacionit ne fuqi), ku numri i punonjesve te jete minimumi 39 persona me kohe te plote pune, ketu perfshihet: "Stafi teknik i shoqerise" sipas pikes "h" dhe "Licencat profesionale te shoqerise" sipas pikes "g" (sqarojme se per "Mjekun", do te zbatohet legjislacioni ne fuqi), dokumenta te konfirmuara nga institucioni perkates sipas legjislacionit ne fuqi (nepermjet formes elektronike).

Referuar Licences profesionale NZ.5147/13 me numer rendor 0430, Regjistruar ne Regjistrin themeltar qe nga data 14.01.2019, ballafaquar me listepagesat e kerkuara dhe DT rezulton se:

- 1. Drejtuesi teknik: Gezim Bisha nuk eshte i perfshire ne listepagesat per sigurimet, per gjashte muajt e fundit me kohe te plote pune, por me 6 dite pune.*
- 2. Drejtuesja teknike Adelina Dukaj nuk eshte e perfshire ne listepagesa per sigurimet, per tre muajt e fundit me kohe te plote pune, por me 11 dite pune.*
- 3. Drejtuesja teknike Alma Velaj nuk eshte e perfshire ne listepagesa, muajin e fundit para hapjes se ofertave (Maj te vitit 2019).*

Komisioni i Shqyrtimi te Ankeses vlereson se subjekti nuk ka te drejte te perzgjedhe drejtuesit teknik qe perfshin apo heq nga listepagesa, qofte edhe ne varesi te llojit te punimeve qe kryhen nga nje autoritet kontraktor. Ne respektim te ligjshmerise se procesit administrativ te licensimit te subjekteve, marredhenieve te punes dhe investimit me fonde shteterore ne te mire te publikut, komisioni vlereson se per sa kohe subjekti eshte i pajisur me license nga nje organ publik ku figuron lista me drejtuesit teknik, keta drejtues duhet te jene ne marredhenie pune prane subjektit, ne respektim te vete licenses.

Operatori Ekonomik detyrimisht duhet te kishte perfshire ne listpagese te gjitha drejtuesit teknik te deklaruar ne licensen e shoqerise NZ.5147/13, me numer rendore 0430, Regjistruar ne Regjistrin themeltar qe nga data 14.01.2019.

Mosperfshirja qofte edhe njerit prej tyre perben kusht s'kualifikues, njekohesisht dhe shkelje fiskale. Nje subjekt qe kerkon te perfitoje nga fondet publike per investime duhet te jete korrekt dhe ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi.

Sqarojme se ju keni pasur ne dispozicion te gjitha instrumentat ligjore per te kerkuar sqarimet e nevojshme, si dhe ndryshimet e mundeshme referuar nenit 42 te ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar "Sqarimet dhe ndryshimi ne dokumentet e tenderit" dhe ne Kreun X, neni 78 pika 4 e Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar.

Komisioni i shqyrtimit te ankeses gjykon se mospermbushja e kriterëve te mesiperme, kriteret qe jane kerkuar nga AK ne DT, perben kusht skualifikues.

Vlen per tu theksuar se KVO referuar nenit 55 te ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ka klasifikuar ne vendin e pare ofertuesin me oferten me te ulet te paraqitur ne kete procedure, ne respektim te kriterit ligjor primar te percaktuar qarte ne ligjin e prokurimit publik (oferta ekonomikisht me e favorshme), operatorin ekonomik Caushi M +

K.M.K + SrNOER AB me vlere te ofertes 12'072'290 leke, i cili sipas vleresimit te KVO permbush te gjithe kriteret e kerkuara ne DT. Gjykojme se nga ju nuk jane permbushur kriteret e kerkuara ne Dokumentat e Tenderit.

II.5. Në datën 30.07.2019, ankimuesi ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 21.08.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1334/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 12964/1 prot., datë 19.08.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me argumentat e BOE ankimues “Biba-X” sh.p.k & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k se: *“Perkatesisht ne piken “h” kerkohet sipas Kritereve/Kerkesave te Pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit per proceduren prokuruese me objekt "Rikonstruksion rruga Taulantia (segmenti Hotel Arvi -Hotel Aragosta)"*

“h.Stafi teknik i shoqerise te kete ne perberje:

➤ <i>Inxhinier Ndertimi</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Inxhinier Hidrodroteknik</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Ing.Topograf</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Ing.Mjedisi</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Mjek</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Teknik Ndëtimi</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Drejtues mjete</i>	<i>7 (shtatë)</i>
➤ <i>Manovratore</i>	<i>5 (pesë)</i>
➤ <i>Punetori e specializuar ne ndertim:</i>	
<i>asfalotshtrues</i>	<i>2 punonjës</i>
<i>karpentiere</i>	<i>2 punonjës</i>
<i>hekurkthyes</i>	<i>2 punonjës</i>
<i>Punetore ndertimi te thjeshte</i>	<i>15 punonjës</i>

Per stafin e sipercituar te paraqitet dokumentacion qe verteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve, licencen e mjekut, deshmi profesionale te punonjesve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj, ndersa per punetore te thjeshte ndertimi, te paraqitet nje vetedeklarim te listes nga shoqeria, ku te deklarohet se jane punetore te thjeshte ndertimi.”

Per permbushjen e pikes h., Bashkimi i operatoreve Ekonomike "BIBA-X-Xsh.p.k & "PE-VLA-KU"sh.p.k kane paraqitur h.Stafi teknik i shoqerise te kete ne perberje:

- *Inxhinier Ndertimi* 1 (nje) *Ing.Lorenc Bani*
- *Inxhinier Hidroteknik* 1 (nje) *Ing. Klodian Zaimi*
- *Ing. Topograf* 1 (nje) *Ing.Bajram Muji*
- *Ing. Mjedisi* 1 (nje) *Ing.Arbana Kola*

Dhe te gjithë pjesën tjetër të stafit të kerkuar në piken h, duke e permbushur teresisht dhe në përputhje me kërkesën në DST.

Në lidhje me përmbushjen e pikës k sipas DST ku kerkohet: “k.List pagesat sipas formulareve standard për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars. Prill. Maj të vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 39 persona me kohë të plote pune, këtu përshihet: “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h” dhe “Licencat profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g” (sqarohet se: për “Mjekun”, do të zbatohet legjislacioni në fuqi). Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike)”, ...duke u bazuar në keto pika Shoqëria “BIBA-X-X” sh.p.k & Shoqëria “BIBA-X-X” sh.p.k kanë plotësuar Aftësitë Teknike të pikave g,h,k të DST, duke paraqitur Licencat e kërkuara me kategoritë dhe me Stafin teknik të kerkuar në piken h të DST, me kohë të plote pune dhe prezent në listpagesa për periudhën e kerkuar Dhjetor 2018-Maj 2019 Ing L.Bani, Ing K.Zaimi, Ing B.Muji, Ing. A.Kola”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Operatorët ekonomikë “Biba-X” sh.p.k & “Pe-Vla-Ku” kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri, me Nr.3350 Rep, Nr.6501 Kol datë 19.06.2019. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “Rikonstruksion rruga Taulantia (segmenti Hotel Arvi – Hotel Aragosta)”.

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Shoqëria “Biba-X” sh.p.k & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k bashkojnë kapitalet, bilancet e tyre, makineritë, pajisjet, fuqinë punëtore, stafin teknik e të tjera dhe janë përgjegjëse solidare për punimet e kryera, detyrimet kontraktuale dhe në mënyrë të vecantë për zbatimin e kushteve të kontratës dhe të grafikut të punimeve. Pavarësisht nga përqindjet e pjesëmarrjes së shoqërive si më sipër në këtë bashkim të përkohshëm do të jenë përgjegjëse individualisht dhe në mënyrë solidare ndaj autoritetit kontraktor në lidhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e prokurimit, konform nenit 423 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë e përbashkët , e shprehur në përqindjet e mëposhtme:

<i>Shoqëria “Biba-X” sh.p.k</i>	<i>90%</i>
<i>Shoqëria “Pe-Vla-Ku” sh.p.k</i>	<i>10%</i>

Sipas kësaj kontrate, shoqëria “Pe-Vla-Ku” sh.p.k merr përsipër të kryejë punimet sipas zërave të preventivit të objektit “Rikonstruksion rruga Taulantia (segmenti Hotel Arvi – Hotel Aragosta)” dhe konkretisht në zërin “Punime gërmimi dhe prishje në rrugë” do të kryejë transportin e dheut me auto deri në 5 km (mbeturian nga prishjet), në zërin “Punime shtresash rrugore” do të mbulojë nënzërin “Ngritje pusete për rakordim kuote në rrugë”, ndërsa në zërin “Punime në trotuar” do të realizojë “Heqje pllaka betoni tek trotualet”, “Heqje bordure betoni ekzistuese”, “FV hekur

në shtresat me beton në trotuare dhe rrugët lidhëse (zgarë 20x20)Ø6. Gjithashtu do të kryejë edhe punime sinjalistike si vizime me bojë, tabela etj.

III.1.2. Në shtojcën 12, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, gërmat “h” e “k” të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, të publikuara në SPE, është parashikuar shprehimisht:

h. Staf i teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:

➤ <i>Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Ing. Topograf</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Ing. Mjedisi</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Mjek</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Teknik Ndërtimi</i>	<i>1 (një)</i>
➤ <i>Drejtues mjeti</i>	<i>7 (shtatë)</i>
➤ <i>Manovratore</i>	<i>5 (pesë)</i>
➤ <i>Punëtori e specializuar në ndërtim:</i>	
<i>asfalotshtrues</i>	<i>2 punonjës</i>
<i>karpentiere</i>	<i>2 punonjës</i>
<i>hekurkthyes</i>	<i>2 punonjës</i>
<i>Punëtore ndërtimi të thjeshtë</i>	<i>15 punonjës</i>

Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve, licencën e mjekut, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj, ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të paraqitet një vetëdeklarim të listës nga shoqëria, ku të deklarojë se janë punëtorë të thjeshtë ndërtimi.

k. List pagesat sipas formularëve standard për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj të vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 39 persona me kohë të plotë pune, këtu përfshihet: “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h” dhe “Licencat profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g” (sqarohet se: për “Mjekun”, do të zbatohet legjislacioni në fuqi). Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se anëtar i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë, “Pe-Vla-Ku” sh.p.k, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, të shoqërisë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k, për periudhën dhjetor 2018 – maj 2019.
2. Kontratë Pune lidhur ndërmjet “Pe-Vla-Ku” sh.p.k dhe K.Z në pozicionin Ing Hidroteknik, diplomë nga Universiteti Politeknik i Tiranës me titull “Ing.hidroteknik” për K.Z. CV, librezë pune.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

III.1.6. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në procedurën e mësipërme të prokurimit autoriteti kontraktor ka kërkuar që stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje, përveç të tjerëve,

edhe një Inxhinier Ndërtimi, një Inxhinier Hidroteknik , një Ing. Topograf dhe një Ing. Mjedisi. Lidhur me këtë kërkesë ankimesi pohon shprehimisht se *Shoqeria "BIBA-X-X" sh.p.k & Shoqeria "BIBA-X-X" Sh.p.k ("Pe-Vla-Ku" sh.p.k) kane plotesuar stafin teknik te kerkuar ne piken h te DST, me kohe te plote pune dhe prezent ne listpagesa per periudhen e kerkuar Dhjetor 2018-Maj 2019 me Ing L.Bani, Ing K.Zaimi, Ing B.Muji, Ing. A.Kola, por nga verifikimi i kryer nga KPP në dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme, rezulton se Ing.Lorenc Bani, Inxhinier Ndertim; Ing.Bajram Muji, Ing. Topograf dhe Ing.Arbona Kola Ing. Mjedisi i përkasin stafit teknik të shoqërisë “Biba – X” sh.p.k ndërsa Ing. Klodian Zaimi, Inxhinier Hidroteknik është pjesë e stafit teknik të shoqërisë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. Referuar rregullave të prokurimit publik në të cilat parashikohet shprehimisht se *kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*, si dhe duke gjuar nga kontrata e bashkëpunimit Nr.3350 Rep, Nr.6501 Kol datë 19.06.2019 ndërmjet shoqërive “Biba-X” sh.p.k & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se shoqëria “Pe-Vla-Ku” sh.p.k duhet të disponojë jo vetëm të ing.hidroteknik, por edhe inxhinierët e tjerë. Kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Shoqëria “Pe-Vla-Ku” sh.p.k ka paraqitur dokumentacion të plotë vetëm për ing.hidroteknik me inicialet K.Z, por ka dështuar të provojë se disponon edhe inxhinierët e tjerë në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes së tij në kontratën e bashkëpunimit me shoqërinë “Biba-X” sh.p.k dhe zërat e punimeve të parashikuara në këtë kontratë si më sipër cituar.*

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik ankimes do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të ankimuesit, përsa i përket BOE “Biba-X” sh.p.k & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit, për shoqërinë “Caushi M” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*”

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislati janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar

apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të mërren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Biba-X” sh.p.k & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k., për procedurën e prokurimit Nr.REF-22807-05-20-2019, me objekt: “*Rikonstruksion rruga Taulantia (segmenti Hotel Arvi – Hotel Aragosta)*”, me fond limit 20.833.000 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 20.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1334 Protokolli

Datë 30.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha